



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 246 Prot.

Tiranë, më 10.12.2020
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Përcillet Vendim i Bordit të Akreditimit

**DREJTUAR: UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR
XHUVANI”
ELBASAN**

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të rradhës, të mbajtur më datë 27 Nëntor 2020, mori vendimin që lidhet me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit periodik institucional të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 49, datë 27.11.2020.

Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se vendimi është i publikuar dhe në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTORI




Elvin Gjevori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 49, datë 27.11.2020

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik institucional të **institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i Institucionit të Arsimit të Lartë: **Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan**
- b) Organizimi i Institucionit: **Publik**
- c) Lloji i Institucionit: **Universitet**
- d) Njësitë kryesore të institucionit:
 - a. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
 - b. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
 - c. Fakulteti i Ekonomisë
 - d. Fakulteti i Shkencave Humane
 - e. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 12.11.1991

f) Akreditimi i parë: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 8, datë 07.04.2017

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga ekspertë të huaj dhe vendas;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm Institucional;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- h. Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dhe rezultatet e akreditimit të parë të këtij institucioni të Arsimit të Lartë;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore, procedurën dhe afatet e përcaktuara nga ASCAL për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Institucioni ka ndërmarrë masa për të përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë;
- e. Rezultatet e vlerësimit të akreditimit periodik janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- f. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për institucionin në fjalë;
- g. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, sipas fushave janë: Fusha 1 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 2 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 3 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 4 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 5 “**përmbushen plotësisht**”, ndërsa vlerësimi i përgjithshëm “**përmbushen plotësisht**”.
- h. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë institucion është Pozitiv.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. **Vlerësimin Përfundimtar POZITIV** për institucionin e Arsimit të Lartë, **Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin Institucional** të institucionit të Arsimit të Lartë, **Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan**, me kohëzgjatjen prej **6 (gjashtë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të institucionit është **26/11/2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA



Kryetar

ALEXANDER KOHLER



Anëtar

FABRICE HENARD



Anëtar

ARBEN MERKOCI



Anëtar

ALEKSANDËR XHUVANI



Anëtar

ANILA PAPARISTO



Anëtar

SULO HADERI



Anëtar

LULJETA MINXHOZI

Luljeta Minxhozi

Anëtar

GËZIM VISOKA

Gëzim Visoka

Anëtar

DRINI IMAMI

Drini Imami

Anëtar

FATMIR GURI

Fatmir Guri

Anëtar